

FORMULARI I NJOFTIMIT TËFITUESIT

Pogradec, më 11.08.2021

Për: Operatorin Ekonomik ofertues "ADA-CO" SHPK, me adresë sipas QKB-së "POGRADEC ZONA INDUSTRIALE", me numër NIPT: K64112603J, perfaqesuar nga administratori znj. Selvi Latifllari.

Procedura e prokurimit: Procedurë e Hapur" - "Punë" -"Prokurim elektronik".

Numri i referencës së procedurës: REF-97705-06-08-2021.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Objekti i kontratës "Mirëmbajtje ndertesash", Fondi limit: 14 200 299,8 (Katërmbëdhjetë milion e dyqind mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë presje tetë) lekë, i miratuar me Vendimin e Keshillit të Bashkisë Pogradec Nr. 144, datë 24.12.2020, "Per miratimin dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2021", Seksioni i Sektorit të Arsimit, Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 60 (gjashtëdhjetë) ditë.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 92 datë 14 Qershor 2021.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

1. INA SHPK

NIPT: J61814009W

Vlera e ofertës pa TVSH: 7 267 900,5 (Shtate milion e dyqind e gjashtedhjetë e shtate mije e nenteqind presje pese) Lekë.

2. INFINIT SHPK

NIPT: J74304623M

Vlera e ofertës pa TVSH: 11 349 686 (Nje mbedhjete milion e treqind e dyzete e nente mije e gjashteqind e tetedhjetë e gjashtë) Lekë.

3. ADA-CO SHPK

NIPT: K64112603J

Vlera e ofertës pa TVSH: 11 238 015 (Njembedhjete milion e dyqind e tridhjetë e tete mije e pesembedhjete) Lekë.

4. "2 N" SHPK

NIPT: L31615017L

Vlera e ofertës pa TVSH: 13 188 739 (Trembedhjetë milion e njëqind e tetëdhjetë e tete mijë e shtatëqind e tridhjetë e nente) Lekë.

5. "LLAZO" SHPK

NIPT: K24218401K

Vlera e ofertës pa TVSH: 8 823 595,2 (Tete milion e teteqind e njezete e tre mijë e peseqind e nentedhjetë e pese presje dy) Lekë.

6. NIKA SHPK

NIPT: J76705047U

Vlera e ofertës pa TVSH: 13 588 591 (Trembedhjetë milion e peseqind e tetëdhjetë e tete mijë e peseqind e nentedhjetë e nje) Lekë.

7. REJ SHPK

NIPT: J93711608Q

Vlera e ofertës pa TVSH: 12 572 631 (Dymbëdhjetë milion e peseqind e shtatëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nje) Lekë.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. INA SHPK

NIPT: J61814009W

2. "LLAZO" SHPK

NIPT: K24218401K

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Nga shqyrtimi i ofertes të paraqitur nga operatori ekonomik INA SHPK në SPE, rezultoi se në zbatim të pikës 5 të nenit 66 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, oferta me vlere 7 267 900.5 leke (Shtate milion e dyqind e gjashtëdhjet e shtate mijë e nenteqind pike pese) lekë pa TVSH, është anomalisht e ulët.

Për sa me sipër, në zbatim të nenit 93 të Ligjit Nr.162/2020, "Për Prokurimin Publik", **i është kerkuar me shkresën 393/9 prot dhe për të paraqitur me shkrim brenda datës 05.08.2021, ditën e Enjte, ora 16:00**, shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit.
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës.

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi.

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës.

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

Ne rast se shpjegimet NUK paraqiten brenda afatit të sipercituar, perban shkas për skualifikim.

O.E INA SHPK, me shkresën me lende "Argumentim i ofertes anomalsiht të ulet" e protokolluar pranë N.M.I.P.P me Nr.393/10prot, datë 06.08.2021, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, nga ana e Komisionit të Vleresimit të Ofertave, u bë verifikimi elementeve të ofertes dhe analizave të kostos për zbatimin e punimeve.

Komisioni i Vleresimit të Ofertave, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur, konstatoi si më poshtë vijon:

Pothuajse, në të gjitha zerat e analizave teknike të objektit, të paraqitur, rezulton se difekte, cka ka cuar në vlera shumë të ulta, të detajuar si më poshtë:

Zeri i preventivit, "Lyerje me boje hidromat", oret e punës për një m², të pasqyruar në argumentim është 0.113, ndërsa manuali i cmimeve të ndërtimit e ka në 0.36. Pra kemi një shmangie, goxha të madhe, për realizimin e shërbimit për 1m², cka çon në mosrealizimin e shërbimit, sipas çelësise dhe specifikimeve të kerkuara në S.P.E.

Zeri i preventivit, "Riparim shtrese me pllaka", nr. analize 2.267/b, oret e punës për një m², të pasqyruar në argumentim është 1.162, ndërsa manuali i cmimeve të ndërtimit e ka në 2.46. Pra kemi një shmangie, goxha të madhe, për realizimin e shërbimit për 1 m², cka mund të çojë në mosrealizimin e shërbimit, sipas çelësise dhe specifikimeve të kerkuara në S.P.E.

Zeri i preventivit, "F.v dyer porte e hyrjes, permasat 1.6x2.4 dru/alumin/plastike dopioxham", nr. analize 2.395/1, në analiza e cmimit të derës, nuk është llogaritur cmimi i energjisë elektrike, për prodhimin, furnizimin dhe vendosjen e derës nëpër objektet e percaktuara.

Zeri i preventivit, "F.v dërr metalike", nr. analize 2.390/1+an, në argumentimi i analizës së dërrguar, cmimi është 6350 lekë pa TVSH, ndërkohe që në faktura bashkëngjitur, po ke është blerë me një cmim nga ju, në vlerën 12 083 leke pa TVSH. Pra, në këtë mënyrë nuk faktehet cmimi i vendosur në ofertë.

Zeri i preventivit, "Mur tulle me kater vrima, trashësia 10 cm, lartësia 3 m, llac perzieres, M15", nr. analize 2.83, në analiza e cmimit të paraqitur kemi vlerën 6 500 leke, ndërsa në manualin e cmimeve të ndërtimit, është vlera 15 622 leke, ku kemi shmangie në realizimin e proceseve të punës si, perzierja e llacit, ngritja e skeles dhe tullat me vrima.

Zeri i preventivit, "F.v zgare metalike", nr. analize 2.374+an, në argumentimi i analizës së dërrguar, cmimi është 296 leke pa TVSH, ndërkohe në manual 2 456 leke, dhe me e rendesishmja O.E INA SHPK, nuk e fakton dot me faktoren blerjes pasi është e dates 05.2020, ndërkohe që cmimi i hekurit përgjate 1 viti është rritur shumë.

Zeri i preventivit, "F.v dyer te brendsme druri (2x1), importi i cilesise se pare ", nr. analize 2.383/1, ne analiza e cmimit te deres dhe oferte eshte 6371 leke pa tvsh, nderkohe ne manual eshte cmimi 12 441 leke pa tvsh, dhe cmimi i ofertes nuk faktohet ose dokumentohet me dokumentacion shoqerues.

Vlen te theksohet se faturat e paraqitura jane te vitit 2020, nderkohe qe pergjate vitit 2021, jane rritur shume cmimi i cimentos, hekurit dhe elementeve te tjere.

Zeri i preventivit, "F.v dere metalike 2x3.5x1, 0.8x1.95 oborr", nr. analize 2.390/1+an, ne analiza e cmimit te deres dhe oferte është 4950 leke pa tvsh, nderkohe në faturën e blerjes është i pasqyruar cmimi per dere al teke, ne vleren 12 083 leke pa tvsh.

Se pari nuk provon dot cmimin e ofruar ne oferte.

Se dyti, dihet qe cmimi i deres metalike eshte me i shtrenjte se dera alumini, dhe perseri me cmimin e paraqitur nuk faktohet realizimi i sherbimit te kerkuar.

Zeri i preventivit, "F.v dyer te brendshme (1x2x3) druri importi cilesi e pare", nr. analize 2.383/1, ne analiza e cmimit te deres dhe oferta e paraqitur është 850 leke pa tvsh, nderkohe në manual cmimi eshte 21 441 leke pa TVSH, me diference 20 591 leke.

Se pari, nuk provon dot cmimin e ofruar ne oferte, pasi nuk ka fature tatimore bashkengjitur qe te deshmoje cmimin e blerjes.

Se dyti, ka handicap shume te madh, midis cmimit te paraqitur ne analize ne 696 leke ne 17 500 leke qe parashikon manuali, ne diference 16804 leke pa tvsh.

Së treti, ne analiza e cmimit te paraqitur, ne kundersizim me analizen qe parashikon manuali, O.E nuk ka parashikuar elementin "Te ndryshme 3 %", cka perben shkas per skualifikimin e ofertes ekonomike.

2.383/1	F V dyer te brendshme druri importi cilesi e I-re.	m2			
	Sp + p	op	0.66	185	122
	Sigurime shoqerore 16.7%	leke	122.1	0.167	20
	Transport	T*km			
	Dyer druri importi cilesi e I - re	m2			
	Te ndryshme 3 %	leke			

Per sa me sipër, Komisioni i Vleresimit te Ofertave gjykon si më poshtë vijon:

Argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor.

Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve,

për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

K.V.O gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatori ekonomik, oferta e të cilit ka rezultuar anomalisht e ulët.

K.V.O gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët.

K.V.O. gjykon se risku që shfaqet në këtë rast është në disa drejtime si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik.

Per sa me sipër, Komisioni i Hapjes dhe Vleresimit të Ofertave, vendosi te skualifikoje ofertën e paraqitur nga Operatori Ekonomik INA SHPK, me ofertën e paraqitur, me vlerë pa TVSH: 7 267 900.5 (Shtate milion e dyqind e gjashtedhjet e shtate mije e nenteqind pike pese) Lekë.

2. Nga shqyrtimi i ofertes të paraqitur nga operatori ekonomik LLAZO SHPK në SPE, rezultoi se në zbatim të pikës 5 të nenit 66 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, oferta me vlere 8 823 595,2 (Tete milion e teteqind e njezete e tre mije e peseqind e nentedhete e pese presje dy) lekë pa TVSH, është anomalisht e ulët.

Për sa me sipër, ne zbatim te nenit 93 të Ligjit Nr.162/2020, "Për Prokurimin Publik", **i eshte kerkuar me shkresën 393/8 prot dhe për të paraqitur me shkrim brenda datës 05.08.2021, ditën e Enjte, ora 16:00**, shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit.
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës.
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi.
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës.
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

Ne rast se shpjegimet NUK paraqiten brenda afatit te sipercituar, perban shkas per skualifikim.

Ne pergjigje te shkreses nr. 393/8 prot, datë 03.08.2021, O.E deri me date 09.08.2021, nuk ka kthyer pergjigje.

Kerkesa per argumentimin e ofertes anomalisht te ulet, i eshte derguar si te rubrika e mesazhve - kerkesat ne S.P.E dhe ne adresa e emailit te vendosur nga ana e tij ne ekstrakti i QKB.

Te dyja keto menyra parashikon si ligji, aktet nenligjore si dhe manuali per zhvillimin e procedures se prokurimit me mjete elektronike.

Mos paraqitja e argumentimeve perkatese, perben shkas per skualifikim.

Per sa me siper, Komisioni i Hapjes dhe Vleresimit të Ofertave, vendosi te skualifikoje oferten e paraqitur nga Operatori Ekonomik LLAZO SHPK, me ofertën e paraqitur, me vlerë pa TVSH: 8 823 595,2 (Tete milion e teteqind e njetete e tre mije e peseqind e nentedhjete e pese presje dy) lekë.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik ofertues "ADA-CO" SHPK, me adresë sipas QKB-së "Pogradec Zona Industriale", me numër NIPT: K64112603J, perfaqesuar nga administratori znj. Selvi Latifllari, se oferta e paraqitur pa TVSH ne vlere prej 11 238 015 (Njembdhjete milion e dyqind e tridhjete e tete mije e pesembdhjete) Lekë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

**[TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR]
ENTON BERBERI**